STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 16 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) JEP FONDET E PARA TE RIMBURSIMIT PER QENDREN MJEKESORE NYU (NYU MEDICAL CENTER), QE ARRIN NE ME SHUME SE 114 MILIONE DOLLARE

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) dha sot rimbursimet e para që kur goditi Uragani Sendi (Sandy) për Qendrën Mjekësore NYU Langone (NYU Langone Medical Center), duke njoftuar më shumë se 114 milionë dollarë për të ndihmuar në mbulimin e kostove që kanë lidhje me përgatitjet përpara stuhive, largimet dhe shpenzimet e tjera që kanë lidhje me stuhinë.

Guvernatori vizitoi sot Qendrën Mjekesore NYU Langone (NYU Langone Medical Center), një nga klinikat dhe qendrat kërkimore më të mira të vendit, për të dhënë këto fonde dhe për të parë dëmin ende të mbetur pas, si dhe përparimin e bërë që nga stuhia.

"Komunitetet anembanë pjesës së poshtme të Nju Jorkut (New York) u shkretuan dhe u shkatërruan nga Uragani Sendi (Sandy) dhe tani është koha për t'u rindërtuar më të fortë sesa kurrë më parë," tha Guverntoari Kuomo (Cuomo). "Këto rimbursime të para federale do të ndihmojnë Qendrën Mjekesorë NYU Langone (NYU Langone Medical Center) dhe 20,000 mjekët, shkencëtarët, infermieret dhe personelin e saj që të trajtojnë një pjesë të dëmit të jashtëzakonshëm të shkaktuar nga Sendi (Sandy) dhe të rikthehen tek përqëndrimi në shërbimin dhe kujdesin për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers)."

Qendra Mjekësore NYU Langone (NYU Langone Medical Center) do të marë 114,632,500 në fonde të rimbursimit për të ndihmuar mbulimin e kostove që kanë lidhje me përgatitjet përpara stuhisë, largimet, heqjen e ujit dhe riparimet e emergjencës menjëherë pas stuhisë.

Rimbursimet e sotme u dhanë pas një procesi të bashkërenduar të kërkesës me zyrtarë shtetërore dhe federalë. Një Ndërlidhës Shtetëror i Ndihmës Publike punoi me Bashkërenduesin e FEMA-s për Ndihmën Publike për të ndihmuar pushtetet vendore dhe njësitë e tjera si NYU Langone që të hartonin një kërkesë duke dokumentuar se ç'farë pune ishte bërë tashmë dhe ç'farë pune ende duhet bërë në të ardhmen për t'u rimëkëmbur plotësisht nga dëmi i shkaktuar nga stuhia. Ndihmë Publike tjetër pritet për të kompensuar kostot e qarkut për heqjen dhe eleminimin e mbeturinave.

Ken Langone, Kryetar i Bordit të Qendrës Mjekësore NYU Langone (NYU Langone Medical Center), tha, "Uragani Sendi (Sandy) tregoi se kush janë heronjtë e vërtetë të Nju Jorkut (New York), siç u tregua në pikun e stuhisë këtu në Qendrën Mjekësore, kur personeli ynë dhe reaguesit e parë të qytetit dhe të

shtetit tonë rrezikuan gjithshka për të ndihmuar që të sillnin sigurinë për qindra pacientë. Që përpara sesa Uragani Sendi (Sandy) të godiste Nju Jorkun (New York), në pikën më të keqe të stuhisë dhe pas saj, Guvernatori Kuomo (Cuomo) ka qënë në terren në komunitetet e prekura, duke dëgjuar banorët, duke parë vetë dëmin dhe duke siguruar se çdo burim i disponueshëm dërgohet për të ndihmuar me rimëkëmbjen dhe rindërtimin. Duke punuar nga afër me përfaqësuesit e Shtetit në Kongres nga të dyja partitë, veçanërisht Senatorët Shumer e Xhillibrend (Gillibrand) dhe Përfaqësuesit King dhe Loui (Lowey), ai ka qënë duke kryesuar luftën për ndihmën federale. Njoftimi i sotëm është një fitore e madhe për shtetin tonë dhe do të ndihmojë Qendrën Mjekësore që të sigurojë shërbime jetësore për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers)."

Robert Grossman, Dekani dhe CEO i Qendrës Mjekësore NYU Langone (NYU Langone Medical Center), tha, "Qendra Mjekësore u shkatërrua nga Uragani Sendi (Sandy), duke shkaktuar dëm të madh dhe duke shkaktuar kosto shumë më tepër sesa mund të përballojmë. Njoftimi i sotëm është një fitore e vërtetë për Qendrën Mjekësore, pacientët tanë dhe të gjithë Qytetin, pasi do të na lejojë që të drejtojmë burimet tona për t'u shërbyer atyre që kanë nevojë për ndihmë shëndetësore sesa për të paguar për kostot e rimëkëmbjes. Shteti i Nju Jorkut (New York State) nuk mund të rimëkëmbet i vetëm dhe prandaj jemi kaq mirënjohës që Guvernatori Kuomo (Cuomo) është në vijën e frontit, duke nxitur Kongresin për të pranuar se është koha që vendi të fillojë të na ndihmojë – ashtu siç kemi bërë për shtetet e tjera kaq shumë herë në të kaluarën. Gjithashtu jemi shumë mirënjohës ndaj personelit të Departamenteve të Shëndetësisë dhe të Sigurisë së Vendit të Shtetit, me të cilët jemi duke bashkërenduar vazhdimisht ndërsa punojmë drejt rihapjes në kohë dhe të sigurtë të mjediseve tona. Vazhdimisht Guvernatori Kuomo (Cuomo) ka luftuar për ne e ka dhënë rezultate dhe e ka bërë këtë edhe njëherë."

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418